



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery	15.03.2022	2	viti god year
Organ /Jesia Organ /Jedinica Org /Unit	SKOPSHEK	1389/2022	115
Nr Prot Br Prot Prot No		Shtjca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.119/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.119/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rruga [redacted] në Komunën e Gjilanit, kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.119/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Në bazë të Vendimit me nr.31832 të datës 15.10.2018 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, ankuesja është emëruar ushtruese e detyrës e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës.

Komuna e Kamenicës më datë 01.11.2018 ka shpall konkursin për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën e Kryetarit të Komunës, ndërsa në bazë të të gjitha provave, pas përfundimit të këtij procesin ankuesja, është konsideruar si kandidatë e suksesshëm dhe më datë 09.01.2019 i është lëshuar akt emërimi për këtë pozitë të cilin e ka nënshkruar Udhëheqësi më i Lartë Administrativ dhe ankuesja.

Në bazë të provave të lëndës, rastin e emërimit të ankueses në pozitën "Zyrtar Ligjor 2",



është trajtuar nga Agjencia Kundër Korrupsion për shkak të shqyrtimit të mundësisë së konfliktit të interesit, ndërsa Agjencia Kundër Korrupsion rastin e ka paraqitur në Prokurorinë e Shtetit. Prokuroria Speciale më datës 31.03.2021 përmes Aktvendimit ka bërë hudhjen e kallëzimit penal, duke konstatuar që nuk është privuar që Kryetari i Komunës ka kryer vepër penale për të cilën dyshohet, duke konstatuar që nëse udhëtimit i njëkohshëm i pozitës së stafit politik dhe pozitës së shërbimit civil nuk përbën shkelje të natyrës penal por përbënë shkelje të natyrës administrative, po meqë pala nuk ka marr pagë për dy pozita nuk është shkaktuar ndonjë dëm.

Kryetari i Komunës së Kamenicës më datë 07.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 36732 me të cilin ka bërë lirim të ankesës nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, duke e obliguar Zyren e Personelit t'a largoj nga lista e pagave në muajin vijues.

Ankuesja fillimisht më datë 14.12.2021 përmes emailit ka kërkuar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore që të përfshihet në listën e pagave në pozitën që është përzgjedhur me konkurs, ndërsa më datë 12.01.2022 përmes emailit ka kërkuar që nuk mund të jem në vendin e punës për shkak që do t'i ndjek procedurat e tjera meqë rasti im në këtë muaj nuk është proceduar.

Pasi që nuk ka marr përgjigje në kërkesat e saj, ankuesja më datë 25.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës për mos përfshirje në sistemin e nëpunësve civil në pozitën Zyrtar Ligjor të fituar me konkurs.

Komisioni për Ankesa për Nëpunësit e Shërbimit Publik më datë 01.02.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 2624 me të cilin është shpall jo kompetent për të vendosur për këtë rast duke theksuar që kompetent për këtë është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja, përmes emailit [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net), më datë 13.02.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 14.02.2022 me numër të ankesës A.nr.119/2022 dhe Nr. Prot:701/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.02.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Me datë 21.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komunën e Kamenicës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:701/2022 të datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesja në



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 13.02.2022 të ankueses; Ankesën e ankueses e datës 25.01.2022 e parashtruar pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës; Vendimin e datës 15.10.2018 për emërimin e ankueses ushtruese e detyrës e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës; Akt Emërimin e datës 09.01.2019 për pozitën Zyrtar Ligjor; Kërkesë për fillimin e rekrutimit e datës 14.08.2018 për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Raportin final i rekomandimi nga Komisioni Rekrutues i datës 30.11.2018; Kërkesë për iniciimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ligjor e datës 13.08.2018; Vendim mbi përzgjedhjes e kandidatit për pozitën Zyrtar Ligjor i datës 10.12.2018; Njoftim-Rekomandim i datës 10.12.2018; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 03.12.2018; Vendimin e datës 07.12.2021 për lirim nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit; Emailin e datës 14.12.2021, 01.02.2022, 12.01.2022 të ankueses; Aktvendim për hudhjen e kallëzimit penal i datës 31.03.2021 nga Prokuroria Speciale; Vendimin e datës 01.02.2022 të Komisioni për Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 21.02.2022; Njoftim për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit e datës 10.05.2019; Përgjigje në kërkesë për dhënien e informatave e datës 01.03.2021 nga Menaxheri i Personelit për Prokurorinë Speciale; Konkursin e datës 01.11.2018 për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Vendimin e datës 20.11.2018 për formim të Komisionit për intervistim të kandidatëve; Raportin e datës 22.11.2018; Regjistrimin e aplikacioneve të pranuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komuna e Kamenicës duhet ta kthej në listën e pagave dhe të kompensoj nga muaji dhjetor 2021 sepse në pozitën Zyrtar Ligjor është përzgjedhur sipas konkursit të rregullt.

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, ankuesja sipas Regjistrimit të Aplikacioneve të Pranuar, ka aplikuar në konkursin e shpallur më datë 01.11.2018 nga Komuna e Kamenicës për pozitën Zyrtar Ligjor 2, ndërsa në bazë të njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 03.12.2018, ankuesja ka rezultuar si konkandidate e suksesshme me 87.5 pikë, për këtë më datë 09.01.2019 i është lëshuar edhe Akt Emërimi për këtë pozitë, duke qenë në të njëjtën kohë edhe duke e ushtruar detyrën në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës në bazë të vendimit të datës 15.10.2018 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, mirëpo në bazë të Përgjigje së Menaxherit të Personelit të Komunës së Kamenicës të datës 01.03.2021 të dërguar për Prokurorinë Special, ka konfirmuar që e njëjta edhe pse ka nënshkruar akt emërimin nuk e ka ushtruar pozitën Zyrtar Ligjor dhe nuk ka marr pagë për këtë pozitë.

Meqenëse në kohën kur është zhvilluar procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar Ligjor 2, ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,



atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 4 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcakton se: *“Zyrtarët e zgjedhur në pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara nuk janë nëpunës civil (në tekstin e mëtejshëm: “funksionarët publikë”).”,* në këtë rast, pozita që ka mbajtur ankuesja ushtruese e detyrës e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës, ka qenë pozitë e funksionarit publikë.

Nëse i referohemi Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si ligj i aplikueshëm në kohën e rastit të ankueses, gjegjësisht neni 14 paragrafi 2 përcakton se: *“Funksionaret publikë mund të konkurrojnë si kandidatë të jashtëm për vende të lira pune në shërbimin civil dhe nuk do të kenë trajtim të privilegjuar gjatë procesit të zgjedhjes. Funksionaret publikë të cilët e kalojnë me sukses ekzaminimin dhe testimin sipas këtij ligji do të marrin statusin e nëpunësit civilë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet dhe do të heqin dorë nga statusi i tyre i funksionarit publikë, si dhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse”,* atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se edhe pse ankuesja në kohën kur është shpallur konkursi për pozitën Zyrtar Ligjor 2, ka qenë në pozitë të funksionarit publik, nuk i është ndaluar që të aplikoj në pozitë të shërbimit civil apo edhe të del si kandidat e suksesshme, mirëpo sipas kësaj dispozite ka qenë e përcaktuar që të heqë dorë nga statusi i tyre i funksionarit publikë, si dhe na të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse, si rrjedhojë në bazë të provave të lëndës, ankuesja vetëm e ka nënshkruar Akt Emërimit më datë 09.01.2019, por nuk ka heqë dorë nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës deri më datë 07.12.2021 kur Kryetari i Komunës së Kamenicës ka nxjerr vendim për lirim nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e lartcekura, ankuesja ka pasur obligim të heqë dorë nga pozita e funksionarit publikë, në kohën kur është përzgjedhur në pozitë të shërbimit civil, dhe pasi që të ketë hequr dorë, ka mund të bëjë pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës sipas nenit 89 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik”,* mirëpo në bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës.

Andaj bazuar në të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqë ankuesja nuk ka vepruar në pajtim me nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke mos hequr dorë nga pozita e funksionarit publikë në kohën kur është përzgjedhur në pozitë të shërbimit civil, atëherë llogaritet që ka humbur pozitën e shërbimit civil dhe nuk mund të kthehet në atë pozitë pas përfundimit të mandatit të funksionarit publikë, rrjedhimisht pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.



Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.119/2022, datë 15.03.2022

Avdyt BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.